

Procesverbal

Konsultim publik: *Me Banorët e Njesisë Administrative Lopës*

Data: 31/07/2026

Ora: 10:00

Vendi: Qendra e fshatit Sinanaj

Numri i pjesëmarrësve: Gjithësej 40 persona të pranishëm. (9 gra dhe 31 burra).

1. Titulli i Projekt – aktit që konsultohet: 1. Hartimi i dokumentit të parë për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027-2029. 2. Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM)

2. Pjesëmarrës :

1. Gramos Sako (Kryetar i Bashkisë)
2. Arben Gumeni (Kryetari i Këshillit Bashkiak)
3. Julinda Karteri (Nënkryetare e Bashkisë)
4. Artur Ormeni (Administrator i Njesisë Administrative Lopës)
5. Adi Vala (Drejtorja e Shërbimit Publik)
6. Gazmend Groshi (Drejtorja e Tatim Taksave)
7. Gëzim Shehu (Drejtori i Zhvillimit Rural)
8. Avni Abedini (Përgjegjës Drejtorja e Zhvillimit Rural)
9. Ela Skënderaj (Koordinatorja e Informimit dhe Konsultimit Publik)
10. Mjaftoni Zeraaj (Anëtare Keshilli)
11. Latif Kacaj (Anëtar Këshilli)

- **Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni,** përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen në dëgjuesën publike të organizuar për Hartimin e dokumentit të parë për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 dhe Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Ai theksoi se fokusi kryesor do të jetë të shërbimet bazë në komunitet, si pastrimi, ndriçimi publik, mirëmbajtja e varrezave, shtrimi i rrugëve, si dhe mbështetja për blegtorinë, duke ftuar pjesëmarrësit të paraqesin mendimet dhe nevojat e njësive të tyre për t'u përfshirë në buxhetin e vitit 2027.
- **Administratori i Njesisë Lopës, Z. Artur Ormeni:**

Pershendetje te gjitheve, faleminderit per pjesemarrjen ne kete degjese te organizuar nga keshilli bashkiak per PBA 2027-2029, projekt buxhetin 2027. Ju jeni sot ketu per te shprehur shqetesimet

dhe kërkesat tuaja për ti reflektuar në buxhetin vitit 2027. Qëllimi i kësaj dëgjese është të degjojme nevojat dhe kërkesat tuaja, të gjithë mund të flasim për to. Problematika në njësinë tonë rrugët e brendshme të fshatrave, restaurimi i lerrave, ujësjellës kanalizime dhe furnizimi me ujë në fshatin Sinanaj, ndricimi publik në qendrat e fshatrave, kanalizimet e rrugëve, pastrim kullotash, investim në kopshte dhe shkollë, pastrimi i varrezave.

Më pas, fjalë iu dha z. Gazmend Grosha, përgjegjës i tatimit të aksave. Ju falenderoj për prezencën tuaj në këtë dëgjese publike.

Programi i investimeve kapitale 2027-2029 kanë vlerën 108,350 mijë lekë. Burimet e financimit janë :

- Transferta e pakushtezuar
- Të ardhurat e bashkisë

Në arsim :

- Rikonstruksion i shkolles "Avni Rustemi"
- Bashkefinancim për rikonstruksionin e shkolles "7-Marsi",

me qëllim përmirësimin e kushteve të mesimit dhe krijimit të ambjentëve me të sigurta për nxënësit. Për sa i përket infrastrukturës rrugore :

- Rikonstruksion rrugësh në qytet dhe blloqe banimi
- Rikonstruksion rrugësh rurale
- Sisteme dhe asfaltim në zonë të ndryshme

Sherbime Publike :

- Blerje mjeteve të transportit
- Blerje kontejneresh për menaxhimin e mbetjeve
- Përmirësimi i kapaciteteve të shërbimeve publike

Bujqësi dhe burime natyrore :

- Rehabiliteti i digës së ujëmbledhësit Turan
- Përmirësimi i kullotave
- Hartimi i planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave

Godina dhe projekte të reja :

- Rikonstruksioni i godinës së Njësise Administrative Qender
- Hartimi i projekteve dhe preventivave për investime të ardhshme

Objektivat Kryesorë të PBA 2027-2029, Bashkia Tepelene synon :

- Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike

- Zhvillimin dhe mirembajtjen e infrastruktures
- Mbeshtetjen e arsimit dhe institucioneve publike
- Zhvillimin e zonave rurale dhe turizmit
- Forcimin e mbrojtjes civile
- Rritjen e transparences dhe eficiences ne perdorimin e fondeve publike

Konsultimi me qytetaret, kjo degjese publike eshte nje mundesi e rendesishme per qytetaret dhe grupet e interes per te paraqitur :

- Propozime per investime
- Kerkesa per permiresimin e sherbimeve
- Sugjerime per zhvillimin ekonomik dhe social te territorit

Sugjerimet dhe opinionet e paraqitura do te shqyrtohen gjate hartimit te Dokumentit Perfundimtar te rogramit Buxhetor Afatmesem 2027-2029.

Adif Ormeni;

Gezim Shehu: Kemi 2 lera, një në Dorez dhe një në Sinanaj.

Kryetari I Bashkise, z.Gramos Sako: Jam në dijeni të cdo problematike.

Pjesëmarrësit që morën fjalën dhe diskutuan dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet si vijon:

Ilir Llanaj (Kryeplaku i fshatit Dhemblan) : Kerkojme 10 peme. Dhe nje lulishte tek lapidari.

Kryetari I Bashkisë, z.Gramos Sako: Kemi 3 projekte per te cilat kemi aplikuar, presim miratimin. Matohasanaj-Dhemblan-Kordhaj, presim miratimin.

Adif Ormeni: Probleme rruget, kanalizimet, lerat, problem me kryesor eshte uji. Lagjja Dashaj ne Sinanaj te behet nje depo, dhe nuk ka kosto shume te medha. Per depot duam vetem materialet.

Artur Ormeni: Shqetesimi i parafolesit per ujin ne fshat do projekt sepse eshte ne prone private.

Kujtim Hameti: Ky uje eshte per interest e fshatit Sinanaj, por nuk mund ta furnizoj te gjithe fshatin.

Adif Ormeni: Mendoj se grumbullimi I ujit nuk bene gjera te medha, por eshte minimalist.

Valter Shameti : Adif, ti si pjesetar i asaj depozite furnizohesh vetem ti.

Kujtim Hameti : Ardhja juaj eshte e kote, asnjehere nuk e keni sjell ujin. Aty pine 2-3 familje, ne nuk kemi uje.

Arben Gumeni: Këshilli Bashkiak e ke thirrur drejtorin e ujesjellesit, projektet janë bere, tani vetem presim . Miratimi nuk varet nga ne por nga ujesjellesi.

Baki Luzi: Rrethimet ne varreza jane degraduar. Rruga ne Matohasanaj, Duam nje lere ne Matohasanaj. Gjithashtu nje pjese rruge Brenda fshatit qe ne dimer shkaterrohet, duam materialet sepse e bejme vete. Uji qe po flitet ketu nuk del per te gjithë fshatin. Pak familje furnizohen.

Adif Ormeni : Dhashe nje mendim per nje zgjidhje provizore dhe te perkohshme.

Antoneta Lulaj: Kam 38 vjet banore ne Sinanaj. Kam nje problem te madh. Kam nje burre te semure 22 vite. Kam nevojë per nje pune ketu.

Ilir Llanaj : Varrezat, rrethim dhe pastrim I tyre.

Kryetari I Bashkise, z.Gramos Sako : Materialet ua sjellim, por nuk kemi fuqi punetore. Nese gjeni nje usta e shikojme.

Ilir Llanaj : Çdo pune qe behet te verifikohet.

Kryetari I Bashkise, z.Gramos Sako : Do te bejme uren ne Dorez.

Ilir Llanaj : Nje ure tjeter ne Dhemblan dhe ju te na ndihmoni vetem me bazen materiale. Uje ne Dhemblan nuk kemi as 20 minuta, edhe lagjja Mehmetaj.

Artur Ormeni : Ne lidhje me shqetesimet me siper per varrezat jam dakort, perfeksion nuk ka por jane korrur. Per restaurimin ne cdo prone private nuk mund ti gjejme. Per investimet ne lagjen Tahiraj jane investuar leke sa ne gjithë zonen.

Ilir Llanaj : Te therritem nje dite dhe nuk erdhe. Eshte e mira qe nje dite te vish dhe te shohesh gjendjen.

Jaho Suli (Kryeplaku I fshatit Lab Martalloz) : Uje, rruge dhe ndricim.

Fatos Hoxha : Lagjja Dashaj pa uje. Cezma ka 35 qe nuk bie asnje pike uje. Duam nje specialist uji te vij te shoh cezmen. Per varrezat, kam 25 vjet qe rrethimin e kam bere vete personalisht, tani eshte hequr dore. Kam nje shtepi, e cila kufizohet me rruge ng ate dyja anet. Ne dimer vjen balta, duhet te nderhyet.

Elidon Tuka: Rruga kryesore ne qender te Dhemblanit eshte e pakalueshme.

Valter Shameti: Duhet nje pastrim rruge per te ardhur ne fshatin Sinanaj.

Fatos Hoxha: Kam 2 parcela pa certificate te zhvendosure.

Julinda Karteri: Në ASHK dergo dokumentat perkatese me plan rilevimi me nje topograf te licensuar dhe behet korrigjimi.

Granit Rrapi: Qender shendetesore mungon. Shkollat te bashkohen sepse ka kushte, te vihet vetem nje fugon per transportin.

PLANI I MENAXHIMIT TE INTEGRUAR TE MBETJEVE

Adi Vela: Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane përbën një nga shërbimet publike me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, ruajtjen e shëndetit publik dhe rritjen e cilësisë së jetesës së komunitetit.

Në këtë kuadër, Bashkia Tepelenë ka ndërmarrë procesin për hartimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për periudhën 2026–2031, i cili do të shërbejë si dokumenti kryesor strategjik dhe orientues për organizimin, administrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë.

Hartimi i këtij plani synon të evidentojë gjendjen aktuale të shërbimit, problematikat dhe nevojat ekzistuese, të përcaktojë objektivat afatmesme dhe afatgjata, si dhe masat konkrete që duhet të ndërmerren për garantimin e një sistemi më funksional, të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet ligjore dhe mjedisore.

OBJEKTIVAT PËR PERIUDHËN 2026–2031

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve do të synojë përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë dhe eficiencës së shërbimit, rritjen graduale të mbulimit të territorit dhe krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të kontrollueshëm.

Objektivat kryesore për periudhën 2026–2031 do të përfshijnë:

- shtrirjen graduale të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë;
- përmirësimin e frekuencës së grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve;
- shtimin, zëvendësimin dhe mirëmbajtjen periodike të kontejnerëve;
- përmirësimin e mjeteve dhe pajisjeve teknologjike në funksion të shërbimit;
- krijimin gradual të kushteve për ndarjen e mbetjeve në burim;
- nxitjen e ripërdorimit dhe riciklimit të materialeve të përshtatshme;
- reduktimin e depozitimeve të paligjshme dhe rehabilitimin e zonave të ndotura;
- rritjen e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit me komunitetin;
- forcimin e kontrollit, monitorimit dhe raportimit mbi realizimin e shë

Mbajtëse të P/Verbalit

Klevisa Kume

Efjenia Masho

Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë

web: www.tepelena.gov.al

E-mail: info@tepelena.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Listë Prezenca e personave të pranishëm në dëgjesën publike të zhvilluar në datën 28.07.2026 në Qendrën e fshatit Sinanaj, ora 10:00. Njësia Administrative Lopës.

Takim konsultuese: Hartimi i dokumentit të parë për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027-2029. Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM).

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Institucionon/organizata	Email/telefon	firmë
1	Artur Boashim Olu	Administrato		
2	Adil Durrës	Sh. P. loku		
3	Mirajon Zeng			
4	Leyan Llami			
5	Artur Zeng			
6	Jaho Zeng			
	Arif Abesir	Specifika		
8	Luigi G. G.			
9	Altin Isola	Prunyes		
10	Shkëlqim Meti	Prunyes		
11	Arjend Hoxha	Prunyes		
12	Lamid Sulaj			
13	Makrim Hoxha	Prunyes		
14	Ervin Durrës	BAND		
15	ALBERT LLANAJ	BAND		
16	Bato Luraj	Bash. Kryes loku		
17	Artan Hoxha			
18	Shkëlqim Hoxha			
19	Valter Tharbo			

20	Migema Zeraj		
21	Holena Ormeni		
22	Ali Ahmetaj		
23	Floren Korsa		
24	Fatos Hoxhaj		
25	Efjencia Masho		
26	Klervisa Kame		
27	Xhulica Meta		
28	Gjenerik Lami		
29	Gjermir Greshi		
30	Gjini Shani		
31	Latif Llogaj		
32	Ela Skenderaj		
33	Juliana Korku		
34	Adil Veli		
35	Antoneta Dulaj		
36	Mikez Liscaj		
37	Besmir Sulej		
38	Dukëmir Yari		
38	Saimir Sejdi		
40	Amorica H. Piretari		
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			
49			
50			
51			
52			

FOTO NGA KONSULTIMI PUBLIK NË NJËSINË ADMINISTRATIVE LOPËS





